



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KUKËS

Adresa "Sheshi Skenderbej" lagj.Nr.5

www.kukesi.gov.al

tel/fax 0242 (2) 5110

Nr. 55 Prot.

Kukes me, 29.06.2017

**K O N T R A T E**

E lidhur sot me date 29.06.2017, mes paleve te meposhtme :

BASHKISE KUKES, e njohur si person juridik ne baze te ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per vetqeverisjes vendore", me Nr. identifikimi tatimor NIPT-i K578292011 me adrese: "Sheshi Skenderbej", Lagjia Nr.5 - Kukes, te perfaqesuar nga Kryetari Z.Bashkim Shehu

dhe

SUBJEKTIN "XHBM NECI", i pajisur me license profesionale Nr. - MK/1186/1, dhe me Nr. Identifikimi Tatimor NIPT K77925234S, me seli ne adresen: Lagjia Nr.6 Kukes.

**OBJEKTI I KONTRATES:** Mbikqyrja e punimeve te ndertimit ne objektin: "*Sistemim-Asfaltim i unazes veriore te qytetit Kukes, karburanti i vjeter- stacioni Morin*"

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per vetqeverisjen vendore", ligji Nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", ligji Nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" (*i ndryshuar*), ligji Nr.44/2015, date 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative ne Republiken e Shqiperise", ligji Nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" neni 7 (*i ndryshuar*), udhezimit Nr.3, date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" (*i ndryshuar*), udhezimit Nr.2, date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit", udhezimit Nr.1 date 16.06.2011 si dhe urdheri i prokurimit Nr.274 date 16.06.2016 "Per prokurimin me vlere te vogla"

Secila pale siguron palen tjeter se ajo ka te drejte dhe fuqi te plote juridike qe te hyje ne kete kontrate dhe se kjo kontrate perben nje dokument legal dhe te vlefshem.

**Neni 1**

**Qellimi i Kontrates**

Mbikqyrja e punimeve te ndertimit ka per qellim kontrollin e mbarévajtjes te te gjithë procesit te zbatimit te punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, destinacionin e objektit, si dhe ushtrimi i përgjegjësisive ligjore për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve per objektin e meposhtem:

*"Sistemim-Asfaltim i unazes veriore te qytetit Kukes, karburanti i vjeter- stacioni Morin*

Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga persona fizikë/juridikë, të pajisur me certifikatë profesionale sipas kërkesave të percaktuara në VKM Nr.759, datë 12.11.2014 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi"

## Neni 2

### Emerimi i Mbikqyresit të Punimeve

Emeron Mbikqyresin e Punimeve pas përzgjedhjes nepermjet procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar).

Mbikqyresi i punimeve nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatimin e objektit që do të drejtoje dhe për çdo shkelje të dispozitave ligjore/nenligjore mban përgjegjësi administrative.

## Neni 3

### Vlera e Kontrates

Pagesa e shërbimit do të kryhet kundrejt faturimit (*Fatures Perfundimtare*). Autoriteti Kontraktor (AK) pas kryerjes së shërbimit, do t'i paguaje subjektit, shumën e percaktuar në bazë të ofertës fituese, ku vlera e përgjithshme e kontratës është:

Emertimi	Çmimi (leke)
Mbikqyrja e punimeve të ndertimit në objektin: Sistemin-Asfaltim i unazës së qytetit Kukes, Karburantit i vjetër- Stacioni Morin".	229.200
TVSH 20 %	45.840
<b>Çmimi i pagueshëm:</b>	<b>275.040</b>

- Çmimi i lartpërmendur përfshin çdo kosto dhe shpenzim që është përballuar nga Kontraktori me qëllim të përmbushjes së objektit të kontratës.
- Pagesa për kryerjen e shërbimit do të bëhet në leke dhe do të disbursohet përkundërt kërkesës së operatorit ekonomik. Pagesa do të kryhet me transferte bankare në llogarinë rrjedhese të subjektit pranë Union Bank-Dega Kukes Nr.10214551060550317194020119

## Neni 4


### Afati i zbatimit të kontratës

Afati i kësaj kontrate fillon nga data e nënshkrimit të saj deri në momentin e marrjes në dorezim të objektit nga ana e Autoritetit Kontraktor.

## Neni 5

### Detyrimet e Mbikqyresit të Punimeve

Mbikqyresi i Punimeve është i detyruar të kontrollojë çdo ditë procesin e zbatimit të punimeve në objekt, kushtet teknike të zbatimit, si dhe kontrollin e materialeve të ndertimit referuar standarteve teknike shtetërore. Ai ka të drejtë të që të ushtrojë aktivitetin e tij profesional dhe në drejtim të verifikimit të ecurisë së punimeve, cilësive së materialeve dhe konformitetit të tyre, në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.



## Neni 6

### Detyrat dhe Përgjegjësitë e Mbikqyrës të Punimeve

Palët do të ushtrojnë bashkëpunimin e tyre në përputhje me objektin e kontratës me specifikimet dhe procedurat përkatëse të përcaktuara në këtë kontratë. Secila palë do të sigurojë vazhdimësinë e marrëdhënies ndërmjet tyre, duke u bazuar në parimin e korrektesës në përmbushjen e detyrimeve respektive.

a. Mbikqyrësi i Punimeve (supervizori) është pjesë e strukturës përgjegjëse për ndërtimin e objektit, dhe:

- Mban dhe përgjigjet, për dokumentacionin e zbatimit të punimeve të ndërtimit
- Është i detyruar të kontrollojë, çdo ditë zbatimin e punimeve të ndërtimit.

b. Në çastin e fillimit të punimeve, mbikëqyrësi duhet të bëjë verifikimet paraprake, si më poshtë vijojnë:

- Verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës.
- Verifikimin e sheshit të ndërtimit, për fillimin e punimeve.
- Njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes.

c. Mbikëqyrësi i Punimeve (supervizori), pas verifikimeve të përcaktuara me sipër, harton dokumentacionin e mëposhtëm:

- Aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit shoqërisë sipërmarrëse;
- Aktin e dorëzimit nga sipërmarrësi të dokumentacionit, teknik dhe administrative.
- Shkresën me atë të së cilës njofton Autoritetin Kontraktor për fillimin e punimeve.

d. Mbikëqyrësi i Punimeve, gjatë zbatimit të punimeve në objekt:

- I jep instruksione dhe urdhëra, me shkrim, sipërmarrësit sa herë që e shih të nevojshme.

e. Mbikqyrësi i punimeve ka përgjegjësi për saktësinë dhe vertetësinë e dokumentave, për cilësinë e punimeve të kryera nga shoqëria zbatuese.

f. Mbikqyrësi i Punimeve ndjek çdo ditë punimet, zbatimin e grafikut të punimeve dhe i raporton Investitorit në lidhje me ecurinë e tyre.


g. Mbikqyrësi i Punimeve veç detyrave të cituara më lart, është përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e të gjitha kërkesave të përcaktuara në dispozitat ligjore/nenligjore "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

## Neni 7

### Ndryshimet e kontratës

Në rast se ndonjëra nga palët dëshiron të bëjë ndryshime apo të kërkojë shërbime të veçanta shtese, veç atyre të parashikuara në këtë kontratë, ajo duhet të njoftojë paraprakisht palën tjetër.

- Mënyra e njoftimit përcaktohet dhe është pjesë e kontratës.
- Për ndryshimet që do të bëhen, palët diskutojnë dhe procedojnë pasi të nënshkruajnë mes tyre akt-marrëveshje/aneks kontrate.



## Neni 8

### Pezullimi i Punimeve

Mbikëqyrësi i Punimeve ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e investitorit, për aq kohë sa quhet e nevojshme korigjimi i gjendjes dhe për shkeljet e konstatuara, mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të propozojë largimin nga puna të një ose të disa personave nga personeli i sipërmarrësit.

## Neni 9

### Ruajtja e Dokumentacionit

Mbikëqyrësi i Punimeve ruan gjithë korrespondencën me investitorin (*Bashkine Kukës*) dhe me sipërmarrësin. Ai mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të objektit, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve, relacionet teknike etj.

1. Mbikqyrësi i Punimeve është i detyruar që të mbaje dosjen e mbikqyrjes së punimeve si dhe një kopje të dokumentacionit të objektit në përputhje me përcaktimet e bera në aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi (*udhëzimi Nr.3 date 15.02.2001, neni 4/a e vijtm*).
2. Mbikëqyrësi i punimeve për të gjitha problemet e verifikuara prej tij, duhet të firmosë gjithçka që ka miratuar.
3. Ai mban përgjegjësi ligjore, së bashku me sipërmarrësin.
4. Një kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i dërgohet kolaudatorit të objektit.

## Neni 10

### Perfundimi i Objektit


Mbikëqyrësi i Punimeve merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës, si dhe firmos proces-verbalin e këtij kolaudimi.

1. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi, në fazat e ndryshme të punimeve. Pagesa mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi. Këto dokumente dërgohen në sektorin financiar të punëdhënësit, bashkë me vërtetimin e përkohshëm të pagesës, për të shpallur vlerën e detyrueshme për pagim.
2. Mbikëqyrësi i punimeve pas përfundimit të kolaudimit, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin perkates, përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit, si dhe i jepet për likuidim investitorit.

## Neni 11

### Ndalimi i kalimit të kontratës ose të një pjese të saj.

Mbikëqyrësi i punimeve nuk mund të heqë dorë nga kontrata apo ndonjë pjesë e saj apo t'ja kalojë të drejtën për të kryer punime një nenkontraktori, pa njofimin paraprak me shkrim drejtuar investitorit.



## Neni 12

### Ligji i Zbatueshem

Kushtet e kontrates do te interpretohen dhe zbatohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Kontrata do te hartohet dhe interpretohet ne gjuhen shqipe

## Neni 13

### Përgjegjësia civile dhe kontraktuale

Operatori Ekonomik në zbatim të shërbimeve te percaktuara ne objektin e kontrates, nuk është përgjegjës për mos-përbushjen e tyre vetem ne rastin e *Forcave Madhore*.

- a. Per ndryshimet eventuale organizative apo strukturore të kryera nga kontraktuesi për të realizuar këtë kontratë, ne rast te mos njoftimit paraprak te kontraktorit, jane ne ngarkim te tij te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga kjo kontrate.
- b. Tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

## Neni 14

### Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Palet mund te bejne ndryshime ne permbajtjen e kontrates me pelqimin e ndersjellte te tyre/per shkaqe te parashikuara ne ligj. Ato jane te vlefshme vetem kur behen me shkrim.

- a. AK-ja mund te terhiqet nga kontrata ne rastin kur kontraktori shkel dispozitat e kontrates dhe arrihet ne perfundimin se ai nuk eshte ne gjendje qe te permbushe detyrimet kontraktore.
- b. Zgjidhja e kontrates behet vetem me shkrim dhe konform dispozitave te percaktuara ne Kodin Civil te Republikes se Shqiperise.
- c. Mos-marreveshjet qe mund te lindin midis paleve gjate zbatimit te kesaj kontrate do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert secila pale ka te drejte t'i drejtohet juridiksionit gjyqesor per zgjidhjen e konfliktit.

### PER PALET KONTRAKTORE

#### PER SUBJEKTIN "NEÇI"

##### DREJTUESI LIGJOR

Xhem NEÇI

(emri,mbiemri, firma & vula)



#### PER BASHKINE KUKES

##### KRYETARI

Bashkim SHEHU

(emri,mbiemri, firma & vula)



Konc.G.Cejku